

20210711063

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 25 paragrafi 1 dhe 3 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 10 DENARË ME KARAKTERISTIKA TË NDRYSHUARA

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 10 denarë me shenjë të emetimit "Април 2020" ("Prill 2020") dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16), Vendimin për ndryshimin e Vendimit për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/17) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 10 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19 dhe nr.88/20), duke filluar nga data 1 prill i vitit 2021.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të jenë edhe kartëmonedhat me vlerë nominale 10 denarë, të emetuara në bazë të Vendimit për emetimin dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16 dhe nr. 12/17).

3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.V. 02-15/IV-2/2021
26 mars viti 2021
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska